

Mblidhet Komisioni i Bursave për Diasporën



Me datë 2 tetor 2020 u zhvillua mbledhja e parë e Komisionit të Bursave për Diasporën, në zbatim të Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020, "Për kriteret e dhenies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021". Komisioni ka për detyrë të ndjekë procesin dhe vlerësimin përfundimtar të dokumentacionit të kandidatëve të cilët do të përfitojnë bursë studimi, institucionin e arsimit të lartë dhe programin e studimit ku do të studiojnë shtetasit e huaj me origjinë shqiptare. Komisioni i Bursave për Diasporën është ngritur me Urdhër të Ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, dhe përbëhet nga tre anëtarë: një anëtar nga ministria përgjegjëse për Arsimin, një anëtar nga ministria përgjegjëse për Politikën e Jashtme dhe një anëtar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

QBD firmos marrëveshje bashkëpunimi mes Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë




Firmoset marrëveshja e bashkëpunimit mes Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën. Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve për mbështetjen dhe përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë. Duke vlerësuar rëndësinë e përhapjes, studimit dhe krijesës së cilësishë së mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë, institucionet ranë dakord për bashkëpunimin e punës për hartimin, përgjedenjen, përshtatjen, përmirësimin e teksteve shkollore dhe literaturës plotësuese për mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë; ofrimin e përvijës për didaktikën e mësimdhënies së gjuhës shqipe jashtë vendit si dhe përgatitjen e materialeve didaktike të mësimdhënies në shërbim të një platforme digjitale të mësimi të gjuhës shqipe, si dhe organizimin e aktiviteteve dhe konferencave të përbashkëta shkencore për trajnimin e mësuesve në Diasporë. Në këtë takim, dekani i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.

"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Mblidhet komisioni i veçantë për vlerësimin e rezultateve të studentëve, që studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë



Më datë 1 tetor 2020, u zhvillua mbledhja e parë komisionit të veçantë për vlerësimin e rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë. Grupi kryesohet nga Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe në përbërje ka zëvendësministrat dhe Sekretarët e Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtorinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Drejtorinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Politike dhe Strategjike dhe Drejtorinë e Drejtorisë së Çështjeve Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjatë takimit virtual anëtarët u informuan për rolin e tyre për fillimin e punës dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për krijimin e një baze të të dhënave shtetërore për të gjithë studentët shqiptarë jashtë vendit si dhe të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, sipas Vendimit Nr. 504, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Publikohet numri i tretë (Shtator 2020) i Buletinit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës

Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën. Gjithashtu, Buletini informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikën, sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të reformës shtetërore për Diasporën.



Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"




App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën diskuton rreth ecurisë së projekteve të Qendrës së Botimeve për Diasporën



Qendra e Botimeve për Diasporën e drejtuar nga znj. Mimoza Hysa organizoi mbledhjen e radhës me Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën, ku ishin të pranishëm: anëtarët e Këshillit: prof. Floresha Dado, përfaqësuese e Akademisë së Shkencave; znj. Mira Hoxha, përfaqësuese e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme; znj. Anila Ferizaj, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe znj. Ada Ilija, Drejtore e Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Në mbledhje u diskutua mbi ecurinë e projekteve të Qendrës së Botimeve për Diasporën, si hartimi i platformës digjitale të mësimdhënies, shpërndarja e teksteve shkollore për diasporën, funksionimi i Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës, ngritja dhe funksionimi i Këshillit të Mësimi Shqip për Diasporën etj.

"Raporto" problemimin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Publikohet revista elektronike

"Shtetësia dhe Regjistrimi Jashtë Vendi për Shtetasit Shqiptarë"

Revista e shtetësisë dhe regjistrimit jashtë vendit për shtetasit shqiptarë është një botim i veçantë elektronik, i cili pëmbledh kuadrin ligjor dhe informon lidhur me procesin e shtetësisë dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Revista jep informacion mbi çështjet që kanë të bëjnë me shtetësinë, procedurën e regjistrimit të shtetësisë si dhe procesin e regjistrimit të adresave të shtetasve jashtë vendit; kuadrin ligjor rregullues, për funksionimin e Shërbimit të Gjendjes Civile në Shqipëri, për rregullat e të dhënave personale, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre.



Botimi dygjuhësh shqip-anglisht "E bukura dhe bisha" dhe "Ujku dhe shtatë kecat", falas nga QBD



E bukura dhe bisha" dhe "Ujku dhe shtatë kecat", dy nga përrallat më të dashura për fëmijët, pjesë e botimeve "Klasikët Dygjuhësh" - projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe anglisht. Libri i sjellë në shqip nga Parid Teferiqi, i pajisur me ilustrime shumë të këndshme, ka një tekst të thjeshtë dhe me fjalë të përdorshme në dy gjuhë që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese. "E bukura dhe bisha" dhe "Ujku dhe shtatë kecat", shqip dhe anglisht vjen falas për fëmijët shqiptarë të Diasporës dhe falas në versionin online për të gjithë.

Publikohet revista elektronike informuese Projekti "Jam Shqiptar"



Revista informuese Projekti "Jam Shqiptar" është një botim i veçantë elektronik, i cili paraqet kuadrin ligjor rregullues për mënyrën e funksionimit të Shkollës Verore në Republikën e Shqipërisë. Shkolla Verore, përmes programit "JAM SHQIPTAR", është një mundësi për pjesëmarrësit shqiptarë të Diasporës nga moshën 11-17 vjeç, të cilët dëshirojnë të vizitojnë vendin e tyre të origjinës si dhe të njihen me natyrën, vendet turistike, mjedisin, traditat, kulturën, doket, zakonet, historinë shqiptare, gjuhën dhe letërsinë shqipe, si dhe paraqet arkeologjike. Qëllimi i Programit "Jam Shqiptar" është organizimi i veprimtarive kulturore, gjuhësore dhe turistike gjatë periudhës të ndryshme të vitit, kryesisht gjatë pushimeve verore, që ndihmon për formimin kulturor, gjuhësor, njohjen me vendet turistike dhe historinë e Shqipërisë të nxënësve shqiptarë në diasporë në funksion të ruajtjes së identitetit kombëtar.

Shefi i katedrës së Albanologjisë në Universitetin e Mynihut, Prof. Bardhyl Demiraj viziton QSPA-në



Në mjetet e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) u zhvillua takimi mes drejtoreshës ekzekutive të QSPA-së, prof. as. Dr. Diana Kastrioti dhe shefit të katedrës së Albanologjisë në Universitetin "Ludwig-Maximilians" të Mynihut, në Gjermani, profesor Bardhyl Demiraj. Në cilësinë edhe të bashkëpunëtorit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) ai u njoh nga afër me veprimtarinë e dritarëve të Qendrës, si dhe me perspektivat dhe mundësitë e bashkëpunimit me QSPA-në dhe Katedrën e Albanologjisë që ai drejton prej 20 vjetësh në Mynih. Profesor Demiraj përveç kontributit pedagogjik, ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme në fushën studimore për dritësimin e emrave të autorëve të shqipes në motmotet e eneta të bujëzimit të shkrimi shqip. Njëherësh është autor i disa librave shkencorë, ka pascur me shprehje filologjike mbi tekstet e traditës arbëreshe, ku ven të përmendim: "Gjaku i shpratur", "Grimca biografike për autorët tanë të vjetër" etj.

"Tregimet e Moçja" të Kutelit në pesë gjuhë, projekti më i ri i QBD-së"



Në Ditën Ndërkombëtare të Përkthimit, Qendra e Botimeve për Diasporën prezanton projektin madhor të përkthimit të "Tregimeve të moçja shqiptare" në pesë gjuhë të huaja: në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe greqisht. Ka qenë kërkesë parësore ruajtja e parimit bazë në përkthimin nga gjuha shqipe: ajo e përzgjedhjes së përkthyesve që kanë gjuhën në të cilën përkthejnë gjuhë amtare. Kështu janë angazhuar në këtë projekt përkthyes të rëndësishëm e me përvijë nga gjuha shqipe, si Andrea Gilli në gjuhën gjermane, Evelyn Noygues në gjuhë franceze Eugenio Scalabrino në gjuhën italiane. Janë angazhuar kështu në këtë projekt dy përkthyes të rinj me gjuhë amtare gjuhën shqipe, por që kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë prej vitesh jashtë vendit e mbi të gjitha janë shkolluar në gjuhën në të cilën përkthejnë: Ron Berish përkthyes i ri dhe përmës i kolliu në përkthajtë Kutelin në gjuhën rcone, ndërsa Eleana Zhako e njohur tashmë në këtë fushë, do të përkthejë veprën në gjuhën greke. Për çfarë përbën për ta ky projekt dhe cilat janë sfidat e punës së tyre. Ja si janë përgjigjur përkthyesit disa pyetjeve lidhur me këtë sfidë.

Për më shumë informacione nga Diasporashqiptare vizitoni:

www.diasporashqiptare.al